

Presidenti i Republikës dekreton 5 përfaqësues dhe ekspertë të KLSH

I lumtur që vlerësoj 5 përfaqësues dhe ekspertë të KLSH, një nga shtyllat më rëndësishme të administratës shtetërore, simbol i paanësisë dhe pavarësisë së tij

Vizitat dhe takimet me institucionin më të lartë të shtetit shqiptar sikurse është edhe Presidenti i Republikës janë gjithmonë mbresëlënëse, të veçanta dhe me vlerë e padiskutueshme për këdo që ka fatin të respektojë dhe të ndihet i nderuar nga numri Një i shtetit, i cili përfaqëson njëkohësisht edhe bashkimin por dhe unitetin, jo vetëm mes njerëzve, por edhe të historisë së lavdishme të kombit tonë. Pikërisht këto momente të veçanta na krijoi edhe ftesa për të qenë të pranishëm më 15 Qershor 2017, ora 12.30 pranë Presidentit të Republikës z.Bujar Nishani, i cili do të kishte të ftuar personalitete me vlera të veçanta të botës akademike, shkencore, universitare dhe intelektuale. Këto vlera i përkisnin një institucioni të pavarur kushtetues që, pa më të voglën mëdyshje, është konsideruar si e vetmia barrierë kundër krimit ekonomiko-financiar, korrupsionit dhe abuzimit me buxhetin dhe taksat e shqiptarëve. Dhe ky institucion është Kontrolli i Lartë i Shtetit, (KLSH) i cili ka marrë edhe vlerësimet maksimale nga organizmat e BE dhe Departamentit Amerikan të Shtetit për përkushtimin dhe vendosmërinë në luftën kundër korrupsionit. Pikërisht për këto vlera dhe kontribute të dhëna nga KLSH, Presidenti i Republikës z. Bujar Nishani dekoroi disa nga figurat që kanë kontribuar për forcimin e këtij institucioni, por edhe që e zgjuan nga gjumi netralgjik që kishte vite që flinte. Personalitetet; doktori i shkencave ekonomike zoti Bujar Leskaj, njëkohësisht edhe Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Profesor Jorgji Bollano, Profesor Omer Stringa, z. Bashkim Spahia, Profesor Skënder Osmani u dekoruan nga Presidenti i Republikës z.Bujar Nishani janë pjesë e kontributit të KLSH, misionit dhe vizionit të saj duke bërë që institucioni më i lartë shqiptar i auditimit të jetë pjesë e denjë e strukturave Euroatlantike. Duhet theksuar, se pavarësisht faktit që sot u dekoruan disa nga personalitetet më të rëndësishme të fushës ekonomike, financiare dhe audituese ky vlerësim shkon edhe për të gjithë ekipin e KLSH, i cili me punën në grup dhe profesionalizmin është kthyer në pjesë e suksesit dhe vlerësimit kombëtar dhe ndërkombëtar. Kontrolli i Lartë i Shtetit është institucioni më i lartë dhe më i specializuar i auditimeve ekonomike e financiare, i cili në veprimtarinë e tij i nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe ligjeve. Mjafton të përmendim disa nga treguesit e KLSH në dy katërvjeçarët e fundit 2008 - 2011 dhe atë të periudhës 2012 – 2015 kur në krye të KLSH ndodhet Dr. Bujar Leskaj.

Tregues të Kontrollit të Lartë të Shtetit në dy katërvjeçarët e fundit		
<i>Vitet 2008-2011</i>		<i>Vitet 2012-2015</i>
<i>52</i>	Kallëzime penale	<i>170</i>
<i>134</i>	Nëpunës të kallëzuar penalisht	<i>530</i>
<i>19,9</i>	Dëm ekonomik i zbuluar në miliardë lekë	<i>162,7</i>

Edhe për periudhën Janar – Dhjetor 2016, KLSH ka ndjekur të njëjtin ritëm pune dhe njëkohësisht edhe suksesi në evidentimin, parandalimin dhe ndëshkimin e rasteve abuzuese në institucionet e audituara prej saj. Ja treguesit:

Tregues të Kontrollit të Lartë të Shtetit për periudhën Janar 2016 - Dhjetor 2016

- 1.Ligji nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”:**456**
- 2.Me Kodin e Punës dhe Kontratën Kolektive apo Individuale të Punës:**586**
- 3.Masat Administrative:**471**
- Shuma (I+II+III): 1515**
- Kallëzime penale: **49**
- Nëpunës të kallëzuar penalisht: **191**

Misioni

Informimi i publikut dhe i Kuvendit të Shqipërisë në lidhje me përdorimin e burimeve me ekonomicitet, efektivitet dhe eficence nga pushteti qendror dhe lokal dhe nga njësi të tjera publike, si dhe nxitja e përgjegjshmërisë në të gjithë sektorin publik, në përputhje me praktikën me të mira të BE dhe me standardet ndërkombëtare të INTOSAI, duke kontribuar për qeverisjen e mirë, nëpërmjet luftës kundër korrupsionit.

KLSH synon të jetë një institucion profesional i besueshëm që i kontribuon shtimit dhe kursimit të vlerës së parave publike, duke dhënë siguri mbi llogaritë financiare të përdoruesve të tyre dhe duke ndihmuar në përmirësimin e menaxhimit të Qeverisë e të enteve të tjera publike nëpërmjet auditimit, duke fituar në këtë mënyrë besim të plotë tek qytetarët shqiptarë dhe të audituarit.

Sfida jonë është një vizion koherent për KLSH, mbi bazën e eksperiencave më të mira të vendeve të BE-së dhe respektimit rigoroz të standardeve ndërkombëtare të kontrollit INTOSAI. Ajo është edhe një thellim i realizimit të misionit të KLSH në luftën kundër korrupsionit dhe abuzimeve në administrimin e pronës publike, një përmirësim i metodologjisë së kontrollit, duke kthyer vëmendjen tek auditimi i performancës, krahas rritjes së efikasitetit të auditit financiar, një sinergjizim i politikave dhe veprimeve me strukturat e tjera shtetërore të së njëjtës fushë, duke ruajtur pavarësinë e KLSH si organi më i lartë i kontrollit ekonomiko-financiar.

Sfida jonë është zhvillimi i burimeve njerëzore të KLSH në nivelin e parametrave të kërkuar nga INTOSAI dhe në përputhje me sfidat integruuese të vendit, si dhe përmirësimi i transparencës në marrëdhëniet me publikun, nëpërmjet një partneriteti të gjerë me median dhe me organizatat jo-fitimprurëse të interesuara për luftën kundër korrupsionit

Ju faleminderit nga zemra në emër të Shtetit dhe qytetarëve shqiptarë!

Bujar Nishani

Presidentit të Republikës

Ndihem veçanërisht i privilegjuar që në cilësinë e Kreut të Shtetit, të organizojmë së bashku sot një ceremoni vërtet të thjeshtë, por kaq të veçantë për nga përmbajtja dhe thelbi i saj vlerësues. Mes nesh kemi sot pesë personalitete, pesë shërbyes të denjë e shembullorë të shtetit, të cilët përveçse jetën ia kushtuan arsimit universitar, por janë shndërruar gjithashtu në pesë ekspertë që kontribuan e vazhdojnë të kontribuojnë cilësisht e me devotshmëri në Kontrollin e Lartë të Shtetit, në këtë insitucion kaq dinjitoz e të rëndësishëm në mbarëvajtjen ekonomike dhe kontrollin financiar të shtetit shqiptar. Kontrolli i Lartë i Shtetit në tri dekadat e fundit është modernizuar vazhdimisht, ka rritur cilësinë e punës dhe sidomos paanshmërinë dhe pavarësinë e tij – ashtu siç duhet të jetë vërtet një institucion model kushtetues e bashkëkohor, – duke arritur në këto vitet e fundit parametra të duhur të standardeve evropiane. Prandaj iu përgjigja menjëherë me shumë kënaqësi propozimit të ardhur për këto vlerësime, sepse të vlerësosh me tituj nderi specialistë të vjetër të auditit shqiptar, para se të jetë një nderim për ata, është një krenari edhe për mua si Kreu i Shtetit. Personalitetet që ne vlerësojmë sot si maratonomakë modernë të betejave novatore për zhvillimin e ekonomisë, i kanë shembur muret e pengesave të çfarëdoshme me forcën e motos së famshme të Presidentit amerikan Kenedi: “Mos pyet se çfarë bëri Atdheu për ju, por çfarë bëtë ju për të”.

Profesor Skënder Osmani

Dekorata “Nderi i kombit”

Është një personalitet i njohur i shkencave natyrore, që ndoshta në fëmijërinë e tij të hershme në lagjet e kryeqytetit shqiptar nuk i pati ëndërruar kurrë fushat ku ai do të shkollohej në të ardhmen e tij. Pasioni i tij drejt matematikës në vitin 1981 e shtyu të doktorohej në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, dega matematikë. Por para se ai të certifikohet si shkencëtar me titull, ai që bëri me kohë i tillë. Ka botuar si autor kryesor apo bashkëautor më shumë se 50 tekste universitare dhe pasuniversitare. Ai ka qenë një ndër nismëtarët e krijimit të Departamentit të Informatikës dhe drejtues i “Konferencës Ndërkombëtare të Ujit”, mbajtur në vitin 1999, në Turqi si dhe shumë punime interesante në revistën “Auditim Publik”, botim i KLSH-së

Profesor Jorgji Bollano

Titulli “Mjeshtër i madh”

Është një tjetër personalitet i shkencave ekonomike shqiptare. Ky pedagog i gdhendur në memorien e dhjetëra studentëve të ekonomikut, i ka studiuar financat shqiptare në tërësinë e tyre. Aktualisht ai është Dekan në Fakultetin e Ekonomisë dhe Financës, të Universitetit “Marin Barleti”, anëtar i Komitetit Kombëtar të Drejtimit dhe Kryetar i Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit. Profesor Bollano ka dhënë ndihmën e tij në ngritjen e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Ky patriark i palodhur i shkencave financiare shqiptare nuk ndalet asnjëherë për të ofruar konsulencën e tij në çdo aktivitet të zhvilluar nga ky insitucion.

Profesor Omer Stringa

Titulli “Mjeshtër i madh”

Është një idhull i profesoratit të universitetit tonë. Pedagog karriere dhe aktivist politik e shoqëror qysh nga dhjetori i largët i vitit 1990, ai ka qenë edhe një studiues dhe kontribues “par excellence” në shkencat ekonomike shqiptare. Bir i një familjeje të dëgjuar të Elbasanit, pasi u diplomua për matematikë, ka dhënë mësim gjatë gjithë karrierës në Katedrën e Matematikës në Fakultetin Ekonomik, por nuk ka reshtur së dhëni edhe kontributet e tij të vyera në proceset demokratike të vendit tonë dhe për emancipimin e Arsimit të Lartë e shoqërisë shqiptare në përgjithësi. Doktor i Shkencave në Fushën e Statistikës së Aplikuar, që prej vitit 1984. Ka mbajtur detyra drejtuese në Departamentin e Statistikës, Matematikës dhe Informatikës së Zbatuar, në Fakultetin Ekonomik të UT por edhe si Dekan i Fakultetit të Ekonomisë.

Zoti Bashkim Spahia

Titulli “Mjeshtër i madh”

Bën pjesë në ata specialistë aq të aftë në mjeshtërinë e tyre, sa ndoshta mund të jetë i vetmi që punoi 31 vite në KLSH. Për mëse tre dhjetëvjeçarë ngjiti shkallët e karrierës si auditues i lartë e drejtues departamenti.

Dr.Bujar Leskaj Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit

Dekoruar me Urdhrin “Gjergj Kastrioti Skënderbeu me numër Dekreti 10445, datë 12 .6.2017.

I fundit jo për nga rëndësia, por do të thosha për nga modestia që e karakterizon, është doktori i shkencave ekonomike zoti Bujar Leskaj, njëkohësisht edhe Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit. Kryetari Leskaj ka një kontribut të pamohueshëm në rritjen e llogaridhënies dhe transparencës si dhe ka mundësuar me drejtimin e tij të pagabuar rritjen cilësore të KLSH-së për të qenë një nga institucionet model të shtetit shqiptar. Ai ka arritur të thellojë më tej punën e KLSH në drejtim të luftës kundër korrupsionit dhe abuzimeve me pronën publike, por edhe duke sjellë një përmirësim të dukshëm e të prekshëm të metodologjisë së kontrollit, në sinergji të plotë me institucione të tjera shtetërore. Mund të them me plot bindje se Kryetari Leskaj ka harmonizuar më të mirën e burimeve njerëzore të KLSH-së në partneritet të plotë me të gjithë aktorët e shoqërisë shqiptare në funksion të konsolidimit të shtetit ligjor dhe mbrojtjes së parametrave ekonomiko-financiarë. Por veçanërisht zoti Leskaj ka mundësuar e shënuar një bashkëpunim të shkëlqyer me institucionet homologe jo vetëm të rajonit të Ballkanit, por edhe me ato të vendeve më të përparuara evropiane, duke përafuar standardet e punës e të shërbimit cilësor me ato të Bashkimit Evropian. – merita të pamohueshme që zotit Leskaj i janë njohur edhe ndërkombëtarisht. Për disa minuta jam përpjekur të përshkruaj shkurt trajektoren profesionale të 5 intelektualëve që historinë e tyre e lidhën me ekonominë dhe Kontrollin e Lartë të Shtetit. Këto simbole të Shkencave Financiare Shqiptare janë paskajshmërisht modestë për çfarë ata kanë bërë në jetën e tyre. Por do të ishte e padrejtë për mua si President i Republikës, që

të mos shpalosja në emër të shtetit që më ka zgjedhur në këtë detyrë, vlerësimet më të sinqerta dhe falënderimet më të ngrohta për gjithshka që ata kanë përmbushur si personalitete të ndritura të ekonomisë sonë dhe qytetarë nga më të respektuarit që ka njohur ky vend. Për më tepër që ju jeni mbikëqyrësit dhe rojtarët më të besueshëm e të pakompromentueshëm të financave dhe parave të taksapaguesve shqiptarë.

BUJAR LESKAJ (Doktor i Shkencave Ekonomike)

Të dhëna personale

Emri Bujar

Atësia Farudin

Mbiemri Leskaj

Datëlindja 3 Korrik 1966

Vendlindja Vlorë

Gjendja civile I martuar, me katër fëmijë.

Edukimi

1990 UT Fakulteti Gjeologji - Miniera

1998 UT Fakulteti i Ekonomisë, Dega Financë

2002 UT Fakulteti i Drejtësisë

2003 Universiteti i Nebraskës – Lincoln SHBA – Diplomë për mësimdhënie në nivel masteri në Administrim Publik

2004 Dhoma Kombëtare e Avokatëve, titulli “Avokat”

2005 Universiteti Bamberg, Gjermani – specializim për Financat Publike

2002- 2006 Fakulteti i Ekonomisë, Shkolla e studimeve të thelluara pasuniversitare – Master në Financë

2009 UT Fakulteti i Ekonomisë – Dizertacioni me temë “Senjorazhi dhe disa probleme të tij në Shqipëri”

Grada shkencore

2009 Doktor i Shkencave Ekonomike

Karriera profesionale

1993-1994 Doganier në degën e doganës, Vlorë

1994-1997 Kryetar i degës së doganës, Vlorë

1997 (prill-gusht) Nëndrejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave

2000-2005 Pedagog në Fakultetin e Ekonomisë, Departamenti i Financës

2005-2009 Pedagog i jashtëm në Fakultetin e Ekonomisë

2009- 2011 Pedagog në Fakultetin e Ekonomisë

23 dhjetor 2011 - në vazhdim Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit

Karriera politike

1997-2011 Anëtar aktiv i PD

2001-2005 Anëtar i Bordit financiar të PD

2001- shtator 2011 Anëtar i Këshillit Kombëtar të PD

2005-2009 Deputet i Kuvendit të Shqipërisë

2005-2007 Ministër i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sportit

2007-2009 Anëtar i Delegacionit të përhershëm të Parlamentit në Asamblenë Parlamentare të NATO-s;

2007-2009

2009-2011 Anëtar i Komisionit të Ekonomisë dhe Financave në Kuvendin e Shqipërisë

Drejtues i Institutit të Studimeve Politike "Ismail Qemal Vlora"

Gjuhë të huaja

Anglisht

Botime

“Përfaqësuesit e Vlorës në Kuvendin e Shqipërisë, 1912-2009”, Tiranë 2009

“Brenda dhe Jashtë.....PARLAMENTIT (maj 2007-2009)”, Tiranë 2009

“Senjorazhi”, Punim doktore, Tiranë 2009

“Paraja dhe Banka” (Cikël LekSIONESH), Tiranë 2011

“Leksione në Financë” (Pjesa I), Tiranë 2011,

“Muzat e Qëndresës” (Nëpër libra të kryqëzuar), Tiranë 2011

“Leksione në Financë” (Pjesa II), Tiranë 2012

Artikuj në periodikë shkencorë dhe në shtypin e përditshëm

Pjesëmarrje në Konferenca shkencore

22 Dhjetor 2011

Betuar në Kuvendin e Shqipërisë pas votimit nga Kuvendi më 15 Dhjetor 2011, të dekretit të Presidentit nr.7163, dt.17 nëntor 2011.

Miratuar me 70 vota Pro, 61 kundër, 3 abstenime

Z.Bujar Leskaj, Kryetar i KLSH-së është ideatori dhe bashkëautor në të gjitha botimet e KLSH-së, ku përmendim:

- "Historiku i KLSH-së 1925-2012"

- "EUROSAT", 2012

- "Standartet e auditimit të INTOSAT-t", 2012

- "Udhëzues i auditimit të Performancës", 2012

- Z.Bujar Leskaj, është Kryetar i Bordit të Revistës Shkencore të KLSH-së, "Auditimi Publik", revistë katërmujore që publikohet në gjuhët shqipe dhe angleze. Numri i parë i saj ka dalë në maj 2012.





